

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLOGOC			
GLOGOC MUNICIPALITY			
Pranimi		18/10/2022	
Nj. Org	Numër	Shënimi	Vlerë
01-	060/03	52622	



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna Drenas
Zyra e Kryetarit



Në bazë të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB- 03/2012 MAPL për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, përkatësisht nenit 9, pika 1.3, dhe Vendimit nr. 12-030-786, të datës 04.01.2018, të Kuvendit Komunal, thirret mbledhja e rregullt e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), dhe në emër të Kryetarit të Komunës, Ramiz Lladrovci, ju drejtojmë këtë:

F T E S Ë

Për anëtarin/en _____, nga _____, që të marrë pjesë në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS), lidhur me zhvillimet në Komunën e Drenasit.

Mbledhja e rregullt do të mbahet më datën 21.10.2022, ditë e premte, nga ora 14:00, në Sallën e Kuvendit Komunal në Drenas.

Rendi i ditës:

1. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSBS-së të mbajtur me datë 19.07.2022: <https://kk.rks-gov.net/glogoc/en-content/uploads/sites/10/2022/10/Procesverbali-i-KKSBS-se-se-dates-19.07.2022.pdf>
2. Përgatitjet dhe fillimi i vitit të ri shkollor 2022/2023;
3. Muaji i Ndërgjegjesimit për Sëmundjet Kanceroze të Gjirit;
4. Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 28/ 96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike;
5. Të ndryshme

Kopje: Anëtarëve të KKSBS-së



Kryetari i Komunës

Ramiz Lladrovci

PROCESVERBAL NGA TAKIMI I KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURINË BASHKËSI (KKSB)
IZVEŠTAJ O SASTANKU OPŠTINSKOG ODBORA ZA BEZBEDNOST ZAJEDNICE (OOBZ)

Komuna / Opština: <u>Drenas</u> Data / Datum: <u>21.10.2022</u>	Pranuar <u>25.10.2022</u> 20
	Nj. Org. <u>01</u> Numër <u>060</u> Shitja <u>01</u> Vlera <u>55</u>
Numri i takimit për këtë vit / Redni broj sastanka u ovoj godini: <u>5</u>	
Takim i rregullt / Redovni sastanak ☒ Takim i jashtëzakonshëm / Vanredni sastanak ☐	
Numri i anëtarëve të KKS-së të pranishëm / Broj prisutnih članova OOBZ: <u>17</u>	
A kanë marrë pjesë në takim përfaqësuesit e komuniteteve jo shumicë, nëse janë anëtarë të KKS-së? Da li su predstavnici nevećinskih zajednica, u svojstvu članova OOBZ, prisustvovali sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ Nuk ka anëtarë që përfaqësojnë komunitetet jo shumicë/Nema članove koji predstavljaju nevećinske zajednice ☐	
A kanë marrë pjesë anëtarë të tjerë përveç anëtarëve të KKS-së? Da li je neko osim članova OOBZ prisustvovao sastanku? Po / Da ☐ Jo / Ne ☒ Nëse "Po", ju lutem potenconi organizatën të cilën e përfaqësojnë Ukoliko je odgovor "Da", molimo navedite koje organizacije predstavljaju	
A është kryesuar takimi nga Kryetari i Komunës apo nënkryetari? Da li je sastankom predsedavao Gradonačelnik ili Zamenik? Po / Da ☒ Jo / Ne ☐	
Temat në rendin e ditës / Teme na dnevnom redu: Në mbledhje u diskutuan këto pika të rendit të ditës: 1. Procesverballi i mbledhjes së rregullt të KKS-së të mbajtur me datë 19.07.2022: https://kk.rks-gov.net/gllogoc/ep-content/uploads/sites/10/2022/10/Procesverballi-i-KKS-se-se-dates-19.07.2022.pdf 2. Përgatitjet dhe fillimi i vitit të ri shkollor 2022/2023; 3. Muaji i Ndërgjegjësimimit për Sëmundjet Kanceroze të Gjirit;	

4. Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 28/ 96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike;

Të ndryshme

Ju lutem, potenconi temat tjera për të cilat është diskutuar në të ndryshmet / Molimo navedite druge teme o kojima se diskutovalo:

Konkluzionet / Zaključci:

Procesverballi i mbledhjes së fundit të mbajtur me datën 19.07.2022 është miratuar pa ndonjë vërejtje nga anëtarët e KKSBB-së.

Për pikën e dytë, Drejtori i Drejtorisë Komunale për Arsim, Muhamet Gjoka, njoftoi të pranishmit lidhur me përgatitjet për vitin shkollor 2022/2023. Ai theksoi se të gjitha shkollat janë furnizuar me materiale, gjithash janë pajisje më lëndë djegëse dru, e disa jemi edhe në procedura tenderuese. “Sa i përket zëvendësimit të orëve të humbura gjatë të shtunave, ne i kemi përcjellur njoftimet me kohë, mirëpo vetëm tri shkolla e kanë respektuar. Këshilli i prindërve ka dalë me deklaratë që fëmijëve po iu mohohet e drejta për ditë të lira. Me PC dhe Laptop janë të pajisura gjithashtu me material didaktik”, ka theksuar mes tjerash drejtori Gjoka.

Për pikën e dytë, “Muaji i Ndërgjegjësimit për Sëmundjet Kanceroze të Gjirit”, Drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Arsim Haxhiu theksoi se jo vetëm një muaj po çdo ditë të trajtohet si vetëdijësim se pari vetëkontroll ndaj parandalimit të kësaj sëmundje me kohë. Ai theksoi se QKMF ka pajisjen e Mamografisë për këto sëmundje, por edhe sqaroi tri lloje të qasjes ndaj kësaj sëmundje.

Për pikën e tretë, Drejtoresha për Shërbime Publike dhe Emergjencë, Lumnije Krapë njoftoi për vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 28/ 96 të datës 14.09.2022 në lidhje me zbatimin e masave detyruese për kursim të energjisë elektrike në institucionet e nivelit qendror, lokal dhe ndërmarrje publike; si dhe Formularin për mbikëqyrje të masave detyruese për kursim të energjisë që është përcjell për raportim. Në këtë pikë, drejtoresha njoftoi për këtë vendim dhe emërimin e menaxheres në nivel komunal për raportim në nivel qendror dhe se si të tillë, janë të obliguar të zbatojnë.

Arben Haziri pyeti lidhur me trajtimin e qeneve endacak që në këtë kohë cenojnë sigurinë e fëmijëve dhe qytetarëve në rrugë. Lidhur me këtë, Drejtoresha Krapë, tha se ekziston marrëveshja me StrayCoco për trajtimin e qeneve endacak dhe qytetarët mund të raportojnë të menaxheri i kësaj marrëveshje.

Ndërsa, Komandanti i Stacionit Policor z.Driton Morina për dukuritë negative në shkolla si narkotik, theksoi se nuk ka pas ndonjë rast që është raportuar në dy nivelet e shkollave, mirëpo posedimi i armeve të ftohtave nxënësit e shkollave të mesme është i pranishëm.

Procesverbali u përpilua nga koordinatori i KKS-së:

Izveštaj pripremio Koordinator OOBZ: Laureta Thaqi
(emri, mbiemri dhe nënshkrimi / ime, prezime / potpis)

Procesverbali aprovohet nga Kryetari:

Ramiz Lladrovci

Izveštaj odobrava Gradonačelnik:

Nënshkrimi / potpis

Data e aprovimit / Datum odobravanja: 22.11.2022

Rekomandimet:

- Dërgimi i këtij procesverbali është obligim që del nga UA 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL neni 11 pika 6;
- Procesverbali përpilohet nga koordinatori i KKS-së në Komunën përkatëse;
- Procesverbali duhet të dërgohet në MPB në e-mail adresën: mpb.dsb@rks-gov.net
- Procesverbali duhet të dërgohet në MAPL në e-mail adresën: Shkrimorja.Mapl@rks-gov.net

Procesverbali duhet të dërgohet njëkohësisht me ftesën e takimit të ardhshëm të KKS-së.